




REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data:	<i>Zyrt. 04/ 190 / dt.24/07/2018</i>
Për:	<i>Zyrës së Informimit në Kuvendin Komunal, Zyrës së pranimi dhe Arkivës pranë KK-së, SIA-së, Radio Gjakovës</i>
Nga:	<i>Drejtor i Drejtorisë për Arsim Mr.Sc.Bernard Frrokaj</i>
Përmes:	<i>Drejtorisë së Arsimit</i>
Lënda:	<i>Konkurs</i>

Në bazë të Ligjit mbi Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, neni 5 pika c, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, Ligjit të Punës neni 8, Udhëzimit Administrativ 06/2015 Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ 17/2009 Procedura e Zgjedhjes së Personelit Arsimor në Shkollë, Drejtoria e Arsimit në Gjakovë në bashkëpunim me Save The Children shpall:

Nr	Institucioni	Pozita	Vend i lirë/Zëvendësim
1.	Shkolla "Ukshin Miftari" në Skivjan	Një (1) edukatore	Vend i lirë

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në DKA apo shkarkohet nga web-faqja e Komunës i cili shërben për të konkuruar vetëm për një shkollë/vend pune. Rezumeja Personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë) i fotokopjuar;
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), **certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara tek noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasysh;**
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (**nëse ka**);

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit arsimor:

- Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr.06/2015 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm si dhe akteve juridike që e rregullojnë fushën e arsimit

parauniversitar (Ligji Nr.02/L-52, Ligji Nr.03/L-068 dhe Ligji Nr.04/L-138).
Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre Udhëzimeve Administrative nuk do të shqyrtohen, përkatësisht refuzohen.

III. Për vendet e lira në institucione edukativo-arsimore, kohëzgjatja e kontratës është me afat të caktuar, e cila do të definohet në kontratën e punës, por jo më gjatë se me datë 31.08.2019.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) pranohen nga data 24/07/2018 dhe përfundon me 07/08/2018 deri në ora 15:00 në Zyrën e Pranimi dhe Arkivës pranë Komunës së Gjakovës.

Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi). Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.

Për intervistë do të ftohen ata kandidatë që hyn në rrethin e ngushtë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve juridike të lartcekura.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë në kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Orari i intervistës do të publikohet në tabelën e shpalljeve në DKA.

Edukatore –kualifikimet e nevojshme:

- 1.1. Fakulteti i Edukimit – programi parashkollor;
- 1.2. Shkolla e Lartë Pedagogjike – drejtimi për edukator;
- 1.3. Fakulteti Filozofik dega e pedagogjisë së përgjithshme
- 1.4. Fakulteti i Shkencave Sociale – përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve.

Me respekt !